



## **P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria**

**" Levizhmeri e mirë e orientuar per banoret dhe vizitoret.  
Permisim i impaktit mjedisor nepermjet stimulimit te transportit publik dhe  
traditës se perdorimit te biçikletës."**

## Përmbajtja

P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	5
4. Buxhetimi i programit të Transporti publik dhe lëvizshmëria	5
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Transporti publik dhe levizshmeria.	7

## P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria

### 1. Hyrje

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithëfushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës.

Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

### 2. Politikat e zhvillimit

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar njëkulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik, ne do të përcaktojmë zonat me shpejtesi të limituar 30 km /orë.

Krijimi i hapësirave më miqësore dhe më të sigurta për kalimtarët dhe pedalesit në zonën urbane; shtimi i linjave urbane, suburbane dhe rajonale; krijimi jo vetëm rrugë pedonale, por zona pedonale.

Rishikimi i planit të parkingjeve në të gjithë qytetin.

Mbulimi i shërbimit të transportit publik në të gjithë zonën urbane. Përmirësimi dhe vënia në eficiencë të transportit publik rreth qytetës në mbështetje të një skeme policentrike të zhvillimit të të gjithë territorit administrativ të bashkisë.

### 3. Funksionet:

#### 3.1 F1. Transporti publik vendor

**F1.O1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë, ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër.**

**Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:**

- Ekziston sinjalistika vertikale dhe horizontale, në disa zona janë marr masa për parandalimin e rreziqeve nëpërmjet ndërtimit të bumpeve në afërsi të shkollave dhe nyjeve me qarkullim të lartë këmbësorësh.
- Kemi dy linja të transportit publik qytetas të udhëtarëve Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Zogaj.
- Bashkia Shkodër ka mbështetur kategori të veçanta sociale për transportin qytetas të udhëtarëve.

#### Situata e synuar 2017

#### Situata e synuar 2018

#### Situata e synuar 2019

**Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikë horizontale nëpërmjet vijëzimit dhe ndertimit të bumpeve, si dhe përmirësimi i sinjalistikës vertikale . Mirëmbajtja i linjave të dedikuara për pedaluesit. Projekt Studim i lëvizshmërisë dhe semaforëve. Vendqëndrimi i dedikuar për biçikleta**

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikë horizontale nëpërmjet vijëzimit dhe ndertimit të bumpeve, si dhe përmirësimi i sinjalistikës vertikale kombinuar me semafor. Mirëmbajtja i linjave të dedikuara për pedaluesit si dhe shtimi i tyre.FV semaforësh. Vendqëndrim i dedikuar për biçikleta

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikë horizontale nëpërmjet vijëzimit dhe ndertimit të bumpeve, si dhe përmirësimi i sinjalistikës vertikale kombinuar me semafor. Mirëmbajtja i linjave të dedikuara për pedaluesit si dhe shtimi i tyre.FV semaforësh. Vendqëndrim i dedikuar për biçikleta

**Linja e transportit të**

**udhëtarëve qytetas**

**Fermentim-Bahçallek me 50**

**cikle, me frekuence 15 min**

**paradite dhe 25 min pasdite.**

**Linja e transportit të**

**udhëtarëve qytetas Shkodër-**

**Zogaj katër herë në ditë .**

**Përmirësimi i kushteve të**

**akomodimit të udhëtarëve në**

**stacion dhe në mjedin urban,**

**nëpërmjet monitorimit të**

**integruar me qytetarët.**

**Përgatitja e specifikimeve**

**tekniko-ligjore për konkursin e**

**shërbimit urban.**

Zgjerimi i linjave të transportit urban të qytetit dhe rrethqytetëse si dhe përcaktimi i stacioneve të tyre. Ndërtimi i terminalit për akomodimin e mjeteve transportit të udhëtarëve.

Rritja e performancës së shërbimit urban, qytetas dhe rrethqytetas nëpërmjet rritjes së shkallës së monitorimit të tyre.

<b>Subvencionimi i biletës së transportit urban për nxënësit dhe student (35% meshkuj dhe 65 % femra)dhe kategorive të veçanta te udhëtarëve që përfitojnë sipas dispozitave ligjore.</b>	Subvencionimi i biletës së transportit urban për nxënësit mësuesit dhe kategorive të veçanta te udhëtarëve që përfitojnë sipas dispozitave ligjore.	Subvencionimi i biletës së transportit urban për nxënësit mësuesit dhe kategorive të veçanta te udhëtarëve që përfitojnë sipas dispozitave ligjore.
---	---	---

### 3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
<b>P4.F8.O1.A1</b> Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë, ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër.	15,312


#### 4. Buxhetimi i programit të Transporti publik dhe lëvizshmëria

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Transporti publik dhe lëvizshmëria planifikohet buxheti me vlerë totale 15,312 mijë lekë ndër të cilat, 23 % shpenzime operative, 57% investime, 20 % subvencion.

Tabelë 1 Planifikimi për Transporti publik dhe lëvizshmëria


Programi P5	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani 2016</b>	0	3,876	7,000	0	3,500	<b>14,376</b>
<b>Plani i ndryshuar 2016</b>		3,876	5,500		5,000	<b>14,376</b>
<b>I pritshmi 2016-12-mujor</b>		1,439			4,165	<b>5,604</b>
<b>Plani 2017</b>	0	3,512	3,000	0	8,800	<b>15,312</b>
<b>Plani 2018</b>	0	3,512	3,000	0	6,900	<b>13,412</b>
<b>Plani 2019</b>	0	3,512	3,000	0	12,400	<b>18,912</b>

### P5.Transporti publik dhe levizshmeria



Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Transporti publik dhe lëvizshmëria

### Burimet e financimit për transporti publik dhe levizshmeria.



Grafik 2 Burimet e financimit për financimin e programit për Transporti publik dhe lëvizshmëria

## 5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Transportin publik dhe lëvizshmëria.

Nr. 1	<p><b>P5.F1.01.A1</b></p> <p>Mobiliteti dhe Shërbimi i Transportit Urban</p>	<p><b>Lloje te programit:</b>P5.Transporti publik dhe lëvizshmëria</p> <p><b>Funksioni:</b>F1. Transporti publik vendor</p>
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
<b>i. Situata</b>		
<p>a. Mobiliteti</p> <p>Në kuadër të mobilitetit të qëndrueshëm urban,dhe një trafiku më të sigurtë,si dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave,Bashkia e Shkodrës përballlet me disa sfida:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trafik i ngarkuar si rezultat i qarkullimit të automjeteve, në akset kryesore dhe në qender te qytetit, i cili shpesh herë paraqet raste të drejtuesve te mjeteve të pandërgjegjshëm, të cilët kalojnë kufijtë e shpejtësisë së lejuar.</li> <li>Mungesa e një plani studimor për trafikun, lëvizshmërinë dhe sinjalistikën, në kushtet e ndryshimeve dinamike te infraskures ne qytet.</li> <li>Shërbimi i sinjalistikës realizohet në sinjalistikën horizontale dhe vertikale. Për sinjalistikën horizontale është realizuar vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, korsitë e biçikletave dhe vijëzime te këmbësorëve në degëzimet kryesore. Gjithashtu një vëmendje e vecantë i është kushtuar rritjes së sigurise ne qarkullim në afërsi të shkollave dhe në rrugët me dendësi të madhe populsie përmes plotësimit me sinjalistikën e nevojshme. Për sinjalistikën vertikale në gjithë qytetin janë vendosur rreth 1000 tabela të llojeve të ndryshme. Çdo vit me buxhetin e Bashkisë realizohet blerja e materialeve (tuba dhe tabela) sipas nevojave për zëvendësimin e tabelave të dëmtuara, si dhe përmirësimin e sinjalistikës. Gjatë këtij viti është realizuar zëvendësimi i sinjalistikës së dëmtuar si dhe plotësimi i saj në qytet dhe në njësitë administrative, kryesisht ne plazhin e Velipojës. Ndryshimet për përmirësimin e sinjalistikës bëhen sipas vendimeve të Këshillit të Bashkisë, urdhërave të Kryetarit të Bashkisë, konsultimet dhe sugjerimet me specialistë te Drejtorise se Policisë. Për herë të parë shërbimi i sinjalistikës gjatë këtij viti është realizuar edhe në njësitë administrative kryesisht në Nj.A Velipojë para fillimit të sezonit të plazhit e në vazhdim.</li> </ul> <p><b>Problemete paraqitura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e sigurisë për shkak të papërgjegjshërisë të drejtuesve te mjeteve në pika të caktuara.</li> <li>Nevoja per përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës për lëvizjen me biçikleta si dhe promovimi i pedalimit.</li> <li>Përdorimi i mjeteve të transportit publik nuk ka qenë në nivelin optimal.Për rrjedhojë, përdorimi i automjeteve personale nuk ka pësuar rënie.</li> <li>Nevoja për rishikimin e planit të sinjalistikës</li> <li>Dëmtime te qëllimshme të sinjalistikës.</li> <li>Nevoja për përmirësimin e standarteve të shërbimit nëpërmjet përmirësimit teknologjik dhe cilësisë së bojës rrugore. Zgjerimi i shërbimit në njësitë administrative kamungesë të theksuar të sinjalistikës horizontale e vertikale.</li> </ul> <p>b. Transporti Urban</p> <p>Ky shërbim realizohet ne dy linja te miratuara, të cilat janë në funksion: linjat urbane:</p> <p>Linja 1 (Bahçallek–Fermentim) dhe Linja 2 (Qendër–Shirokë–Zogaj). Linja 1 realizohet me 50 cikle ne dite me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite. Linja 2 shërbehet 4 herë në ditë sipas orareve te miratuara, 3 nga të cilat me destinacion deri në Zogaj.</p> <p><b>Probleme te paraqitura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trafik i rënduar në akse të ndryshme, i cili redukton shpejtësinë e transportit urban, si dhe ndikon negativisht në respektimin e frekuencave, duke demotivuar rrjedhimisht qytetarët në përdorimin e tij.</li> <li>Zënia e vendqëndrimeve nga parkimi i jashtëligjshëm i automjeteve.</li> <li>Mosefiçenca e linjave të tjera</li> <li>Dëmtimi i sinjalistës ekzistuese,si dhe nevoja për streha vendqëndrimesh cilësore,aty ku mungojnë.</li> <li>Kërkesa e operatorit për rritjen e çmimit të biletës.</li> </ul>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<p>Të rritet cilësia dhe siguria e jetës së qytetarëve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i studimit të sinjalitikes së lëvizshmërisë urbane për gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër</li> <li>Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedaluesit</li> <li>Krijimi i kushteve për funksionimin normal të linjave të transportit nga qyteti në drejtim të njësive administrative dhe anasjelltas</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		

## 1. Mobilitet

### Viti 2017

- Rritja e cilësisë dhe sigurisë së jetës së qytetarëve nëpërmjet përmirësimit të sinjalistikës dhe vendosjen e bumeve në pikat më të rrezikshme.
- Hartimi i studimit të sinjalistikës në funksion të lëvizshmërisë urbane për gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër
- Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedalesit
- Shtimi i vendqëndrimeve për biçikleta në pika të ndryshme të qendrave të qytetit
- Promovim i përdorimit të biçikletave me qera në pika ku i shërbejnë lëvizjes brenda qytetit
- Studimi dhe projektimi për ndërtimin e terminaleve dhe agjensive në pikat e hyrjes në qytet duke ulur ngarkesën e trafikut të qytetit si dhe duke ulur ndotjen e ajrit
- Studimi dhe projektimi për ndërtimin e pedonaleve në hapësira publike duke i dhënë përparësi lëvizjes së këmbësorëve dhe lëvizjes me biçikleta
- Në bashkëpunim me sektorin e policisë rrugore të bëhet kompletimi me sinjalistikë në qytet sipas ndryshimeve në infrastrukturë

### Viti 2018

- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Lëvizje me të kontrolluar në kryqezimet kryesore të qytetit e organizuar kjo nga funksioni i semaforëve.
- Eliminimin e parkingut të makinave në sheshin e Bashkisë, duke e orientuar dhe kontrolluar lëvizjet nga kufizues trafiku me pista.
- Lirimi i rrugëve të qytetit nga mjetet motorrike duke i dhënë përparësi lëvizjes me biçikleta në shërbim të qytetarëve
- Krijimin i kushteve duke vendosur tabela orientuese për një njohje dhe orientim më të mirë të lëvizjeve të turistëve në Bashkinë Shkodër, duke promovuar vlerat historike dhe kulturore të qytetit tone.
- Monitorim i lëvizjes së mjeteve private në rrugët kryesore të qytetit.
- Në bashkëpunim me policinë rrugore të bëhet kompletimi me sinjalistikë të rrugëve të qytetit sipas ndryshimeve në infrastrukturë.

### Viti 2019

- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale në bashkëpunim me sektorin e policies rrugore.
- Rritja dhe mirëmbajtja e linjave të pedalimit brenda qytetit.
- Përmirësimi i sinjalistikës horizontale me bojra plastike me jetëgjatësi.
- Studimi mbi vendosjen e bumeve sipas ndryshimit të infrastrukturës të qytetit.
- Stimulimi për kthimin në një biznes të mirëfilltë dhe dhënia e biçikletave me qera.
- Shtimi i vendqëndrimit të biçikletave sipas një studimi të mirëfilltë të ndryshimeve të infrastrukturës në rrugët e qytetit.
- Studim për vendosjen e parkingjeve të automjeteve të kontrolluara nga bashkia.
- Vendqëndrimet e dedikuara për biçikleta.

## 2. Sinjalistika

### Viti 2017

Janë parashikuar shpenzimet për sinjalistikën horizontale e vertikale në bazë të preventivave përkatës. Parashikimipër bazë materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikën horizontale dhe vertikale është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara dhe paisjeve me të cilin realizohet shërbimi. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:

Blerje materiale për sinjalistikë horizontale dhe vertikale

- ✓ Bojë rrugore bikoponente sprajt gjithsej 2200kg
- ✓ Tabela rrugore të ndryshme gjithsej 60 copë
- ✓ Kone ndarëse trafiku gjithsej 15 copë
- ✓ Pulsante gjithsej 6 copë
- ✓ F.V Kufizues shpejtësie ( bume gome )
- ✓ F.V kufizues trafiku me tampon bllokues, territori i Bashkisë.
- ✓ Blerje kamionçini 2.5 ton.
- ✓ Vendqëndrimet e dedikuara për biçikleta

### Viti 2018

Janë parashikuar shpenzimet për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Do të realizohet blerje e materialeve të ndryshme të domosdoshme për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale si: bojë rrugore bikoponente sprajt, tabela rrugore të ndryshme, kone ndarëse trafiku, pulsante, etj

### Viti 2019

Janë parashikuar shpenzimet për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Do të realizohet blerje e materialeve të ndryshme të domosdoshme për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale si: bojë rrugore bikoponente sprajt, tabela rrugore të ndryshme, kone ndarëse trafiku, pulsante, etj.

- Pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje për makinën e vijëzimit.

Në funksion të mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale janë parashikuar shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesorë mund të përmendim: zëvendësim gomash, kompresor, pistoletë boje. Për makinën e vijëzimit është hartuar preventivi përkatës i





pjesëve të këmbimit.

- Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit

Në funksion të mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale janë parashikuar shpenzime për mirëmbajtje. Në zërat kryesorë mund të përmendim: ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

- Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit

Në bazë të normativave të llogaritura parashikohen për dy makinat e vijëzimit 1600 litra në vit.

### Shpenzime të ndryshme viti 2018

Janë parashikuar shpenzimet për:

- Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit
- Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit
- Blerje karburant

### Shpenzime të ndryshme viti 2019

Janë parashikuar shpenzimet për:

- Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit
- Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit
- Blerje karburant

### 3. Transporti Urban

Realizimi i shërbimit në oraret dhe frekuencat e miratuara: Linja 1 (Fermentim–Bahçallëk) 50 cikle me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite) si dhe Linja 2 shërbehet 4 herë në ditë, 3 nga të cilat shërbejnë deri në Zogaj.

Gjatë këtij viti në kuadër të politikave sociale, është parashikuar subvencionimi për rreth 400 nxënës studentë, ku Bashkia mbulon diferencën e çmimit të biletës prej 600 lekësh në muaj, dhe abonenti paguan vetëm 600 lekë nga vlera totale prej 1200 lekë e abonese së përgjithshme.

Monitorimi për zbatimin e frekuencave, orareve, vendqëndrimeve, në përputhje me kontratat e nënshkruara me operatorët, për realizimin e shërbimit do të bëhet nga sektori përkatës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës, Njësi Administrative dhe Policisë Bashkiake. Ndërsa dhënia e subvencioneve për diferencën e çmimit të biletës do të monitorohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Financës.

#### Viti 2017

- Integrimi i rrjetit të shërbimit të transportit urban me njësitë administrative të bashkisë.
- Planifikimi i linjave të shërbimit të transportit publik urban në kuadër të ndarjes së re administrative.
- Hartimi dhe përgatitja e procedurave të konkursit të ri të shërbimit urban.
- Ngritja e stacioneve të shërbimit rrethqytetës në vendet e miratuara.
- Shtirja e shërbimit urban duke mbuluar të gjitha skajet e qytetit si dhe lidhjen me linjat rrethqytetëse me njësitë administrative.
- Në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e të Ardhurave të realizohet monitorimi i shërbimit urban dhe linjave rrethqytetëse

#### Viti 2018

- Organizimi i shërbimit të transportit të udhëtarëve nga një qendër e vetme (terminal) të mjeteve ndërqytetëse dhe ndërkombëtare.
- Lehtësim i trafikut të brendshëm në qytet nga mjetet e udhëtarëve ndërqytetëse, rrethqytetëse dhe ndërkombëtare.
- Në bashkëpunim me policinë bashkiake dhe drejtorinë e të ardhurave të monitorohet shërbimi urban dhe rrethqytetas.

#### Viti 2019

- Studimi i linjave të shërbimit urban duke rritur shërbimin në funksion të ndryshimeve infrastrukturore të qytetit.
- Shtimi i linjave të transportit brenda njësi administrative duke lidhur fshatrat me qendrën administrative
- Shtimi i linjave të transportit sipas një studimi ndërmjet njësi administrative.
- Rritja cilësore e shërbimit urban duke e bërë të preferuar nga qytetarët, në mënyrë që të zvogëlohet lëvizja me automjetet private
- Rritja e kontrollit të transportit në bashkëpunim me policinë bashkiake dhe drejtorinë e të ardhurave.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)

- Rritja e sigurisë në rrugë dhe në hapësirat publike.
- Kushte lehtësuese dhe nxitje për përdorimin e biçikletave si dhe vendqëndrim e tyre.
- Demotivim për përdorimin e automjeteve private.
- Krijimi i kushteve për funksionimin normal të linjave ekzistuese, duke kërkuar bashkëpunimin e Policisë Rrugore.
- Shtim të përdoruesve të transportit urban, nëpërmjet respektimit rigoroz të cikleve dhe orareve.
- Zbatimi dhe nxitja e mëtejshme e politikave favorizuese ndaj shtresave në nevojë.

<ul style="list-style-type: none"> <li>Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm, si dhe më të sigurtë nga aksidentet.</li> </ul>								
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)					
Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës Drejtoria e Financës. Drejtoria e të Ardhurave Operatori i Transportit Nxënës dhe studentë			Bashkia e Shkodrës					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>								
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1.1		<b>Mobiliteti</b>	<b>12312</b>					
	A.1.1/1	Projekt-studim trafiku( lëvizshmëria dhe semaforët)						3000
	A.1.1/2	F.V Kufizues shpejtësie ( bume gome )						2400
	A.1.1/3	Vendqëndrimet e dedikuara për biçikleta			100			
	A.1.1/4	Blerje materiale për sinjalitike horizontale dhe vertikale			3000			
	A.1.1/5	Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit			118			
	A.1.1/6	Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit			22			
	A.1.1/7	Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit			272			
	A.1.1/8	F.V kufizues trafiku me tampon bllokues, territori i Bashkisë.						2800
	A.1.1/9	Blerje paisje pune, xhenerator 6 kw, saldatrice,						600
A.1.2		<b>Transporti Urban</b>	<b>3000</b>					
	A.1.2/1	Subvencione për abonete e transportit urban					3000	
<b>Shuma 2017</b>			<b>15312</b>		<b>3 512</b>	<b>3000</b>		<b>8800</b>
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</b>			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1.1		<b>Mobiliteti</b>	<b>10 412</b>					
	A.1.1/1	Projektstudim. Vendosje Semaforë						1 000
	A.1.1/2	Vendqëndrime te dedikuara për bicikleta			100			
	A.1.1/3	Blerje materiale për sinjalitike horizontale dhe vertikale			3 000			
	A.1.1/4	Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit			118			
	A.1.1/5	Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit			22			
	A.1.1/6	Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit			272			
	A.1.1/7	Plotësim me sinjalitike vertikale orientuese turistike						3 500
	A.1.1/8	F.V bume gome						2 400
A.1.2		<b>Transporti Urban</b>	<b>3 000</b>					
	A.1.2/1	Subvencione për abonete e transportit urban					3 000	
<b>Shuma 2018</b>			<b>13 412</b>		<b>3 512</b>	<b>3 000</b>		<b>6 900</b>

Shpenzimet për çdo aktivitet 2019			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Subv	Kapitale
A.1.1		<b>Mobiliteti</b>	<b>15 912</b>					
	A.1.1/1	F.V. sinjalistikë horizontale (bumpë gome)						2 400
	A.1.1/2	Vendqëndrimet e dedikuara për biçikleta				100		
	A.1.1/3	Blerje materiale për sinjalistikë horizontale dhe vertikale				3 000		
	A.1.1/4	Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit				118		
	A.1.1/5	Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit				22		
	A.1.1/6	Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit				272		
	A.1.1/7	F.V. Sistem Semaforësh						10 000
A.1.2		<b>Transporti Urban</b>	<b>3 000</b>					
	A.1.2/1	Subvencione për abonetë e transportit urban					3 000	
<b>Shuma 2019</b>			<b>18 912</b>			<b>3 512</b>	<b>3 000</b>	<b>12 400</b>
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon) Gjatë vitit 2017, 2018 , 2019			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës					